



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 30 nëntor 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Caktimin e Trupit Gjykses II

Gjykatësve të Trupit Gjykses II:

Gjykatës Çarls Smith III

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Mbrojtjes së Hashim Thaçit:

Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit:

Ben Emmerson

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Aleks Uajting

(Ushtrues i Detyrës së Prokurorit të Specializuar)

Mbrojtjes së Rexhep Selimit:

Dejvid Jang

Mbrojtësit të Viktimave:

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Jakup Krasniqi:

Venkatesvari Alagendra

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(b) dhe 40(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), rregullave 98(3) dhe 115 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton Trupin Gjykues II pas Njoftimit të dhënë në përputhje me Rregullën 98(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake për datën 15 dhjetor 2022 (“Njoftimi”).¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër zotërinjve Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakub Krasniqi. Versioni i redaktuar i vendimit u bë publik më 30 nëntor 2021.²

2. Z. Krasniqi u arrestua në Kosovë më 4 nëntor 2020 dhe zotërinjtë Thaçi, Veseli dhe Selimi u arrestuan më 5 nëntor 2020, në bazë të fletarrestimeve të lëshuara nga

¹ Shih F01131, Njoftim në përputhje me Rregullën 98(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, 30 nëntor 2022.

² Shih KSC-BC-2020-06, F00026, Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakub Krasniqit, 26 tetor 2020, (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*). Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 19 nëntor 2020, F00026/CONF/RED. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 nëntor 2020, F00026/RED. Shih edhe F00034, Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të, 30 tetor 2020, (konfidencial); F00045/A03, Aktakuza e Redaktuar më Tej, 4 nëntor 2020, publike; F00134, Version me më pak Redaktime i Aktakuzës së Redaktuar, KSC-BC-2020-06/F00045/A02, 4 nëntor 2020, 11 dhjetor 2020 (konfidencial). Një version i korrigjuar më tej i aktakuzës së konfirmuar u dorëzua më 3 shtator 2021, (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*) (F00455/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00455/CONF/RED/A01) dhe versionin e redaktuar publik (F00455/RED/A01). Më 17 janar 2022, Prokurori i Specializuar parashtrroi versionin konfidencial të korrigjuar me edhe më pak redaktime të aktakuzës së konfirmuar, F00647/A01. Aktakuza e ndryshuar e konfirmuar u dorëzua më 29 prill 2022 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*) (F00789/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00789/A02) dhe versionin e redaktuar publik (F00789/A05). Më 30 shtator 2022, Prokurori i Specializuar dorëzoi aktakuzën e konfirmuar me disa ndryshime të mëtejshme (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*) (F00999/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00999/A02) dhe versionin e redaktuar publik (F00999/A03). Versioni i redaktuar publik u dorëzua po të njëjtën ditë, F00993/RED).

Gjykatësi i Procedurës Paraprake më 26 tetor 2020.³ Ata u transferuan në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, Holandë, më të njëjtën ditë.⁴

3. Më 30 nëntor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake dorëzoi Njoftimin se dosja e çështjes gjyqësore do të jetë gati për t'i kaluar Trupit Gjykues më 15 dhjetor 2022.⁵

II. CAKTIMI

4. Pas shqyrtimit të kriterëve të parashikuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

KRYETARJA ME KËTË VENDIM CAKTON TRUPIN GJYKUES II, TË PËRBËRË NGA:

Gjykatës Çarls Smith III

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

për këtë çështje gjyqësore, pas dorëzimit të dosjes gjyqësore më 15 dhjetor 2022.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare e Dhomave të Specializuara

³ Shih F00027, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra Transferimi, 26 tetor 2020.

⁴ Shih F00048, Njoftim i Pranimit të Jakup Krasniqit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 4 nëntor 2020; F00053, Njoftim i Pranimit të Hashim Thaçit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe mbi Emërimin e Mbrojtësit, 5 nëntor 2020; F00054, Njoftim i Pranimit të Kadri Veselit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe mbi Emërimin e Mbrojtësit, 5 nëntor 2020; F00055, Njoftim i Pranimit të Rexhep Selimit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 5 nëntor 2020.

⁵ Shih Njoftimin.

E mërkurë, 30 nëntor 2022
Hagë,
Holandë